



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 11.03.2019, ora 15.00

Drejton mbledhjen -

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

1. Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për procedurat e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

Marrin pjesë² :

- | | |
|-----------------------|----------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 5. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 6. Eriol Roshi | (anëtar) |
| 7. Medi Bici | (anëtar zëvendësues) |
| 8. Gurali Brahimllari | (anëtar zëvendësues) |

¹Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED krahas qëndrimeve të tyre për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe të zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

²Anëtarja e Fatjona Memçaj nuk merr pjesë në diskutimin dhe miratimin e akteve nënligjore normative, për shkak të papajtueshmërisë-marrëdhënie krushqie e afërt me kandidaten Ardita Alsula. Sipas ligjit, Kryetari i Këshillit e ka miratuar heqjen dorë me vendimin nr.1 datë 14.02.2019.

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016 :

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetëse të procesit të hartimit të akteve nënligjore të KED :

1. Agnes Bernard, drejtuese e misionit EURALIUS

2. Julinda Beqiraj, eksperte e EURALIUS

3. Maniela Sota, Koço Bendo, përkthyes për EURALIUS

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Informohet Këshilli se nuk merr pjesë në mbledhje për shkaqe shëndetësore anëtarja zëvendësuese Klodiana Veizi.

Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për procedurat e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë rendin e ditës së programuar.

Këshilli vijon mbledhjen me sipas rendit të ditës lidhur me projektaktin : *Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për procedurat e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë*, duke vazhduar diskutimin në pikën 50 të këtij projektakti.

Anëtarët e Këshillit, pas diskutimit e miratojnë me riformulime pikën 50 dhe 51 të projektaktit.

Në vijim, ***anëtarët e Këshillit***, rishqyrtojnë dispozitën e pikës 44 dhe diskutojnë mes tyre mbi propozimin që rregull i votës vendimtare të kryetarit në rast barazie votash, të zëvendësohet me rregullin që në rast barazie votash kandidimi konsiderohet i lejuar.

Erinda Ballanca kërkon fjalën dhe parashtrohet se jam dakort që nëse një personi i shkelet ndonjë lloj e drejte, që ta bëj më vazhdimin edhe ecurinë e kandidimit, kjo e drejtë duhet të shkelet nëpërmjet shumicës reale të votave. Çfarë do të ndodhi nga pikëpamja procedurale, cili do të jetë propozimi më i mirë procedural për ta sjellë këtë në tekst. Kjo më dyshon. Pra, ndoshta mund të themi që propozimi për ndalimin e kandidimit nuk miratohet, si të thuash ndalimi i kandidimit vendoset me shumicën e votave. Nga ana tjetër çfarë do të thotë lejimi i kandidimit, sepse i bie që për lejimin e kandidimit ka një votë më të ndryshme nga vota që bën ndalimin e kandidimit. Edhe mua mu ndalua pjesëmarrja me shumicë votash, e shikoni që më është shkëlur një e drejtë. Mu lejua në rregullat e përgjithshme, në rregullat specifike mu ndalua. Unë mendimin e kam po gjithmonë njësoj.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe parashtrohet se mbështes këtë propozim të Avokates sepse ecim koherent me nenin 249 .” këshilli vendos me shumën e votave”.

Agnes Bernhard (*përkthen përkthyesja*) kërkon fjalën dhe parashtrohet se ka variante të ndryshme që përdoren në të tilla raste dhe mund të referohemi ligjit për organet kolegjiale ku diferencën e bën vota e kryetarit. Megjithatë nisur nga mendimet e dhëna, duket se ato shkojnë në favor të propozimit dhe kjo në fakt do të ishte një linjë e drejtë.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimit, miratojnë propozimin dhe riformulimin e pikës 44 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit, vijojnë me diskutimin e dispozitës së pikës 52 të projektaktit dhe në përfundim vendosin rikonsiderimin e përmbajtjes së saj pas diskutimit dhe miratimit të rregullave të projektaktit mbi verifikimin e pasurisë.

Anëtarët e Këshillit, vijojnë me diskutimin e dispozitës së pikave 53 dhe 54 të projektaktit dhe i miratojnë ato me riformulime.

Anëtarët e Këshillit, kalojnë në diskutimin e dispozitave të Seksionit Ç “Publikimi i akteve të procedurës së verifikimit. Komunikata për median”, dhe i miratojnë pikat 55 dhe 56 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit, kalojnë në diskutimin e dispozitave të Kreut IV “Procedura të veçanta për verifikimin e kandidatëve”

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe miratojnë pikën 57 të projektaktit.

Vijon diskutimi për dispozitat e Seksionit A të këtij Kreu të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe miratojnë pikën 58 dhe vijojnë diskutimin mes tyre për pikën 59 të projektaktit.

Erinda Ballanca, gjatë diskutimit mes anëtarëve, kërkon fjalën dhe, lidhur me formularët dhe autorizimet që duhet të nënshkruajnë kandidatët e personat e lidhur për efekt të verifikimit të

pasurisë e të kushteve ligjore, parashtron se a ka kompetence ligjore Kshilli për ta kërkuar këtë gjë. Po shikoja dispozitat dhe shtrohet pyetja a ka parashikim që ti themi atyre personave që ju duhet të plotësoni dhe autorizimet për ne, për të kërkuar në subjekte publik, privatë, çdo gjë, brenda dhe jashtë territorit. Një referencë që gjej është neni 229 pika 4, kjo është e kufizuar. Prandaj ndoshta duhet ta verifikojmë të drejtën dhe kompetencën që ne kemi për të kërkuar informacion tek subjektet të tjerë privat brenda dhe jashtë territorit. Kjo pjesa jashtë territorit të Shqipërisë edhe nga ana e Vetingut ka rezultuar se ato nuk të kthejnë asnjë përgjigje

Bledar Dervishaj, gjatë diskutimit mes anëtarëve, kërkon fjalën dhe, parashtron se pa dashur të kundërshoj përmbajtjen e kësaj pike, absolutisht, po e shikoja në krahasim me nenin 235 të ligjit që flet pikërisht se çfarë ndodh me kontrollin e pasurisë së kandidatëve. Pika 2 thotë jo më vonë se 15 ditë nga marrja e formularit, kandidatët i dorëzojnë ato të plotësuar pranë inspektorit, i cili kryen kontrollin dhe sjell përfundimet e tij. Pra, dorëzimin e bën tek inspektorati, nuk i dorëzon këtu. ILDKPI pika 3, i dërgon menjëherë këshillit rezultatet e kontrollit. Në përfundimin e procedurës së deklarimit të kontrollit të pasurisë këshilli shpall faktin. Prandaj, a do të kapërcej këshilli mbi konstatimet e ILDKPI-së. Kam qënë shumë dakort, ekspertizat u përfshinë qoftë të gjuhësisë qoftë të ekonomisë, ndoshta për këtë shkak. Nëse këshilli do të vendos të kryej verifikim të thelluar, dhe vlerësim përtej inspektoriatit, ai autorizim do të jepet se sbën.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe miratojnë pikat 60 dhe 61 të projektaktit.

Erinda Ballanca, gjatë diskutimit mes anëtarëve për pikën 61, kërkon fjalën dhe parashtron se këtu parashikohet që formulari i deklarimit të pasurisë çohet drejtpërsëdrejti në ILDKPKI. Ne ndërkohë kemi çuar letra dhe nuk e dimë së çfarë do të kërkojm, kopja e formularit duhet të jetë besoj edhe këtu sepse pa një kopje formulari fizike si do ti verifikojmë ne pastaj pasaktësitë? Ta kuptojmë kush është gjëja më e mirë për të bërë se nuk kam asnjë problem thelbësor, por këto deklaratat e personave për të marrë pjesë në organet e sistemit të drejtësisë nuk janë online. Ky organ kështu nuk mbaron as deri në marsin e vitit tjetër.

Bledar Dervishaj, gjatë diskutimit mes anëtarëve për pikën 61, kërkon fjalën dhe parashtron se ka një moment dhe ka të drejtë Avokati. Ne të gjithë e dimë që ky organ do të ndeshet me një konkurrencë hetimi me ILDKPI-në. Dy organe po vetojnë të njëjtin subjekt për të njëjtat gjëra dhe këtu me të drejtë e ngre Avokatja si shqetësim do të mbarojë ILDKPI-ja dhe do të merret si një veting që kush bën vetingun e merr dhe pastaj fillon hetimin e vet apo paralelisht të dy organet hetojnë mbi këtë subjekt.

Anëtarët e Këshillit shqyrtojnë dhe miratojnë pikat 62 deri 67 dhe vijojnë diskutimin mes tyre për pikën 68 të projektaktit.

Erinda Ballanca, gjatë diskutimit mes anëtarëve për pikën 68, kërkon fjalën dhe parashtron nëse afati 5 ditor është një afat i mundshëm për kandidatët për të mbledhur dokumentat shtesë. Pra, nuk e kam për shpjegimet shpjegimet se ato patjetër që do ti japë për 5 ditë. por te dokumentat se ndoshta s'ka mundësi ti gjejë jashtë shtetit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë pikën 68 dhe vijnë diskutimin mes tyre rreth pikës 69, 70 dhe 71 të projektaktit, lidhur me nevojën e thirrjes së ekspertit për verifikimin e pasurisë, përzgjedhjen e tij dhe veprimet që kryen.

Bledar Dervishaj, gjatë diskutimit mes anëtarëve për pikat 69 deri 71, kërkon fjalën dhe parashtron se lidhur me përzgjedhjen e ekspertëve listën e subjekteve të paktën te fusha ekonomisë financave kontabiliste listën e subjekteve të licensuar e ka Ministria e Financës. Ka ekspertë të licensuar aktiv dhe joaktiv. Prandaj mund të bëjmë një parashikim për zgjedhjen nga institucioni përgjegjës që administron listën e azhornuar të tyre sepse ka dhe të licensuar që janë punojnë në shtet por nuk e kanë aktiv.

Anëtarët e Këshillit miratojnë pikat 69-71 dhe vijnë me shqyrtimin e diskutimet rreth pikave 72 deri 75 të projektaktit, lidhur me nevojën e thirrjes së ekspertit për verifikimin e pasurisë, përzgjedhjen e tij dhe veprimet që kryen.

Erinda Ballanca, gjatë diskutimit mes anëtarëve për pikat 72 deri 75, kërkon fjalën dhe parashtron se çështja e listës së ekspertëve është shumë e rëndësishme. Mos ndoshta do ishte më mirë që Këshilli të miratonte një listë të ekspertëve pasi të kishte marrë mendime që të kishim një listë me 20 vetë dhe nga ajo listë të zgjidhte relatori? Mos është më mirë që Këshilli të kishte një listë të vetën dhe të vendosë disa kritere për ekspertët ? Mund të ketë ndoshta një aplikim nga ata me kërkesë. Ekspertët janë lloj lloj. Për shembull anëtarët që janë nga rrethet nuk i njohin ekspertët e Tiranës sepse duhet edhe pak vlerësim profesional. Shqetësimi im kryesor është që disa nga anëtarët e Këshillit që mund të jenë relator nuk i njohin ekspertët që janë në Tiranë. Se është çështje njohje për profesionalizmin. Mbi bazë e aplikimit mund të kenë ata interes për të qenë apo jo ekspert pranë këtij organi dhe në një mënyrë ti legjitimojë ky Këshill.

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesja), kërkon fjalën dhe parashtron se nuk e njoh mirë praktikën si operoni ju por të paktën nga eksperiencia ime nuk i mbetet vetëm në dorë relatorit që ta bëjë zgjidhjen e ekspertit por është organi kolegjal dhe kjo garanton edhe atë ndarjen e përgjegjësiive më shumë sesa përqëndrimin në një dorë të vetme. Ju kërkoj ndjesë se nuk e njoh praktikën tuaj por në vend që të ishte një relator më mirë ta vendosi një organ kolegjal.

Erinda Ballanca, kërkon fjalën dhe parashtron se çështja e ekspertit ka të bëjë me vendimmarrje të relatorit por më shumë me vendimmarrje që a do ketë një procedurë më të thelluar për të hetuar për X apo Y person apo mjaftohemi me ato dokumente që janë dërguar nga

organet. Ndoshta kjo është çështje e këshillit sepse është një vendimmarrje pak më e rëndësishme. Prandaj jam dakord dhe me ndriçoi ndërhyrja e zonjës Bernhard në lidhje me këtë çështje sepse kjo mund të jetë një problem që nuk duhet ti lënë vetëm relatorit por e duhet trajtuar nga gjithë këshilli nëse duhet bërë një hetim më të thelluar për një person e me pas sigurisht të caktohet një ekspert nga lista dhe të identifikohen pyetjet apo çështjet që duhet të trajtohen në lidhje me thellësinë e hetimit.

Bledar Dervishi, gjatë diskutimit mes anëtarëve për pikat 72 deri 75, kërkon fjalën dhe parashtrohet se krahasimisht me logjikën e legjislacionit tërësor që kemi në përcaktimin e ekspertit, gjithmonë për detyrat e ekspertimit parashtrojnë nevojën e marrjes së një vendimi nga organi apo nga gjykata. Pra vendos organi, ndërkohë që relatori nuk merr vendim. Prandaj mund të thuhet në rregullore që nëse relatori kërkon një ekspert Këshilli vendos caktimin e tij.

Këshilli ndërpret diskutimet për një pushim të shkurtër.

PJESA E DYTË E MBLEDHJES

Anëtarët e Këshillit, pas pushimit, vijojnë me shqyrtimin dhe diskutimet rreth pikës 72 deri 75 të projektaktit dhe në përfundim të tyre diskutimeve i miratojnë këto dispozita me shtesa dhe riformulime.

Anëtarët e Këshillit vijojnë me shqyrtimin dhe diskutimet mbi dispozitat e Seksionit B të këtij Kreu të projektaktit “Verifikimi i integritetit të kandidatëve”, duke filluar me pikat 76 deri 82 lidhur me formularët dhe autorizimet në procedurën e verifikimit, organet ku kërkohet informacion dhe fushën e shtrirjes së verifikimit të kandidatëve mbi integritetin sipas ligjit dhe standardeve kushtetuese të procesit të rivlerësimit kalimtar.

Erinda Ballanca, gjatë diskutimit mes anëtarëve për pikat 76 deri 82, kërkon fjalën dhe parashtrohet se kam një merak të vogël këtu sa i përket kontakteve të papërshtatshme për ata persona që vijën nga bota e avokatisë. Një pjese mirë e avokatëve dhe për shkak të detyrës së tyre që është detyrë kushtetuese kanë mbrojtur edhe persona me probleme. Prandaj them kam një pikëpyetje në lidhje me këtë çështje se si do vlerësohen ata nisur nga kjo natyrë pune ku takojnë persona që u garantojnë mbrojtje. Z. Dvorani ju keni qënë avokat vetë dhe jeni bërë gjyqtar i Gjykatës Lartë shumë i nderuar për vite më radhë, por fakti është që ju mund të keni mbrojtur X apo Y. Zonja këtu që vjen nga Kuvendi dhe ka qënë avokate p.sh N.K. Situata është shumë subjektive prandaj nuk e di si do ta vlerësojmë këtë. Duhet të jem skeptike për këtë gjë dhe gjithsesi unë dua të shënohet kjo në procesverbal, pastaj ju e dini vetë. Kur bëhet kandidati i papërshtatshëm sepse ne nuk kemi asnjë dënim për një ortak p.sh., kur ka qënë ortakëria ai nuk ka

qenë i papërshtatshëm dhe ai bëhet i papërshtatshëm në një moment, sepse ai merret me drogë. Logjika kërkon se si ta zgjidhim këtë.

Mund të jetë edhe element në vlerësimin tonë që kemi persa i përket pikëve, siç ne kemi bërë për organet e vetingut si institucion, për anëtarët që kanë ardhur nga jashtë sistemit dhe për hir të së vërtetës ja nuk po e them. Një nga vlerësimet që ka bërë paraardhësi im, që mos të them unë që e kam bërë unë, i ka vënë zero pikë një personi duke thënë që në gjykimin tim tek integriteti i figurës molare i vë zero pikë sepse ka gjykuar në kohë të komunizmit, ka dënuar njerëz me vdekje. Megjithatë u bë ky vlerësim, po sot ai person është në KLGJ dhe ska asnjë problem. Por dua të them se kur ka vendimmarrje të tjera, ka një renditje, nuk mund të vendosim të gjithë ne që secili mund të bëjë një lloj vlerësimi. Diskutimi i kontakteve të papërshtatshme është një pafundësi sepse kontakti i papërshtatshëm mund të jetë për mospagim gjobash administrative që janë ku di unë çështje X apo Y të përfunduara, mund të këtë probleme të ish bashkëshortit. Pra mund të këtë gjëra nga më të ndryshme e të futemi në një labirint që realisht e bëjnë të pamundur po nuk vendosëm një kriter objektiv për efekt të vlerësimit.

Bledar Dervishi, gjatë diskutimit mes anëtarëve për pikat 76 deri 82, kërkon fjalën dhe parashtrohet se përshtatshmëria ka të bëjë me detyrën që do të marrë subjekti për ta ushtruar e jo kur e ka ushtruar. Kuptohet që në fund të ditës, problemi është për atë që vjen nga jashtë gjyqësorit dhe kontaktet i ka krijuar për shkak të rrethanave që i jep rastësia. A mund ta vendosësh në të njëjtin barazi krahasimorë me një magjistrat që ka detyra të tjera për dhënien e drejtësisë ndër vite. Përshtatshmëria e këtij i lind në momentin që e merr këtë detyrë dhe këtu mbaron. Këtu dalim tek parimi e që sipas ligjit që ky KED duhet të zbatohet nuk e gjen kërkund pjesën e DSIK. A do të hyjë Këshilli tek DSIK për të vlerësuar edhe këto kritere? Ka vetëm një paragraf aty në nenin 237 “Integriteti”, por që 237 ka një gabim le të themi se i referohet në dispozite tjetër 134 pika 1 që ska lidhje fare. Lë pak diapazon të lirshëm kjo dhe këtu Këshilli duhet të shikojë a duhet të hyjmë dhe tek kontaktet. Të paktën unë e vlerësoj shumë mirë kryerjen e këtij procesi hetimorë. Në fund të ditës gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese apo inspektori duhet të jetë një figurë e kulluar, por duhet kujdes se si do vlerësohet e me çfarë kriteresh ky kontakt i papërshtatshëm. Fjala kontakt i papërshtatshëm është e zgjerueshme dhe nuk e ndan dot njëri kush është i papërshtatshëm, p.sh në çfarë lidhje gjaku. Me të drejtë avokatja është në merak.

Anëtarët e Këshillit miratojnë pikat 76-82 të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit vijojnë me shqyrtimin dhe diskutimin e pikave 83 deri 87 të projektaktit, lidhur me procedurat që ndiqen sipas gjetjeve të verifikimit dhe rasteve të ndalimin

të kandidimit lidhur me integritetin e kandidatit. Në përfundim të diskutimeve i miratojnë ato me shtesa dhe ndryshime.

Anëtarët e Këshillit vijnë me shqyrtimin dhe diskutimet mbi dispozitat e Seksionit C të këtij Kreu të projektaktit “Verifikimi i kushteve të tjera ligjore të kandidimit”. Në përfundim të diskutimeve i miratojnë dispozitat e këtij Seksioni.

Anëtarët e Këshillit vijnë me shqyrtimin dhe diskutimet mes tyre mbi dispozitat e Kreut të fundit “Dispozita kalimtare dhe të fundit”.

Agnes Bernhard (përkthen përkthyesja), kërkon fjalën dhe parashtron se kam një rekomandim në pikën e parë të Seksionit C. Këtu i referoheni nëpunësit të shërbimit civil dhe jo magjistratëve. Nëse i referoheni ligjit të vetingut ai gjen zbatim jo ndaj magjistratëve. Po ju jap si shembull që këshilltaret juridik tek gjykatat e ndryshme nuk është se janë magjistratë. Por nga ana tjetër janë subjekt të ligjit të vetingut dhe sigurisht për ta rezultatet e vetingut duhet të merren parasysh dhe të mos e kufizojmë vetëm tek magjistratët.

Sipas ligjit të vetingut, objekt i institucioneve të ndryshme të vetingut është deklarimi deri në fund të 2016. Megjithatë Kushtetuta dhe ligji i vetingut në vetvete ju krijon mundësi organeve që të shkojnë përtej kësaj periudhe kohore. Dhe ideja është që duhet marrë parasysh situata në ditën e seancës dëgjimore sepse mund të thuhet për shembull që nuk është e arsyeshme që ti të rikonfirmosh në detyrë një kandidat i cili deklaratën e pasurisë e ka pasur të pastër deri në fund të 2016 por ndërkohë nga 2016 e deri në ditën kur bëhet seanca ka mangësi dhe boshllëqe dhe mungesë justifikimi të dukshme. Domethënë këtë kompetencë për të shkuar përtej 2016-ës për të bërë verifikimet e nevojshme ne e mbështesim pikërisht tek Kushtetuta dhe tek ligji në vetvete. Në qoftë se ka dyshime të arsyeshme, ka probleme të konstatuara e lëmë në dorë të këtyre institucioneve që të shkojnë në pjesën e verifikimit dhe të ekzaminimi përtej këtij viti. Ndërkohë një tjetër çështje, një tjetër problem është çështja e konsistencës ose e shpeshtësisë së verifikimit. Mbase kjo mund të jetë diçka që do duhet që të pyesni vetë drejtpërdrejt institucionet e vetingut.

Bledar Dervishaj, kërkon fjalën dhe parashtron se tek pika 103 nevojitet një saktësim që mund ta diskutoni për sa i përket përcaktimit se kandidatët që i nënshtrohen vettingut nuk i nënshtrohen procedurës së verifikimit të pasurisë dhe integritetit. Verifikimi nëse ka qenë bashkëpunëtor, anëtar ose i favorizuar i sigurimit të shtetit më duket se ngel nga vetingu e pavlerësuar. Pra në qoftë se ka një magjistrat që ka kaluar vetingun, pjesën e verifikimit të dosjeve të ish Sigurimit të Shtetit a do ta verifikoni?

Po kështu, lidhur me me vakancat e përkohshme që kemi shpallur. E jona përfundon më datë 25 maj dhe këtu janë tre kandidatë që kanë ardhur e që do hyjnë në proces verifikimi. KED-ja mund të ndodhet në proces, përfundon mandati normal për ushtrimin e detyrës dhe hyn në fuqi

procedura tjetër për vakancën e plotë. Pra në qoftë se KED-ja nuk ka përfunduar ende verifikimin, të mbyllet procedimi dhe ndoshta me njoftimin tonë vakanca e përkohshme që do plotësohej nga 3 kandidatët që kanë ardhur përfundon në qoftë se me 25 maj KED-ja nuk ka mbyllur vlerësimin e atyre 3 kandidatëve vlerësim plus renditje, atëherë i bie që kot sa kryhet se duhet të mbyllet si proces. Më duket se e ka edhe Kuvendi një të tillë.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të këtyre diskutimeve, i miratojnë edhe dispozitat e këtij Kreu.

Në përfundim të këtyre diskutimeve, me votim unanim anëtarët e Këshillit e miratojnë në tërësi, me shtesat, ndryshimet e riformulimet e kaluara nen për nen, projektaktin “Për procedurat e verifikimit të kandidatëve për vendet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor i Lartë i Drejtësisë”.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pasi merr mendimin e anëtarëve për rendin e ditës dhe kohën e mbledhjes së ardhshme, duke u përcaktuar zhvillimi i saj në datën 18 Mars, në orën 10.00, me rend dite: *Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*, deklaroi mbylljen e mbledhjes.

MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 19.18

Sekretare

Kryetari

Dorina Dulaj
Ermelinda Kadiu
Redjona Myrtja

Ardian Dvorani

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga personel i vetë institucioneve të ftuar.